



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 63 datë 30.09.2024

PËR

“STREHIMIN EMERGJENT TË FAMILJES BEJTJA NË NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA PRANË QENDRËS KOMUNITARE “PËR FAMILJEN” NR. 6 (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS PYJORE)”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pikës 19 të VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, VKM-së Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, VKB Nr. 27 datë 26.06.2022 “Për miratimin e Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” Nr.6, VKB Nr. 21 datë 29.4.2024 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër”, Relacionin e Drejtorisë së Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile me Nr. 2065/b, datë 24.09.2024 dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Të miratojë strehimin emergjent të familjes Bejtja në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6 (ish-konvikti i shkollës Pyjore).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 38 vota
Vota Pro 38
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion L. LLA

